

14.02.2022  
Ora 18:04

**JASHTË RENDIT TË DITËS**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- |            |       |                       |
|------------|-------|-----------------------|
| • Ilirjana | NANO  | Kryetar               |
| • Arens    | ÇELA  | Anëtar                |
| • Dritan   | ÇAKA  | Anëtar                |
| • Helga    | VUKAJ | Anëtar                |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar                |
| • Stafi    | KQZ   | Y. Merkaj, I. Osmanaj |

Parti           Politike:                           PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)

**OJQ:**

*Znj. I. Nano:* Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, të njoftuar për ditën e sotme, datë 14 Shkurt 2022. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së. Në rendin e ditës të mbledhjes së sotme, kemi shqyrtimin e një projektvendimi. “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në Vendet e Numërimit të Votave në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”. Bazuar në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator, më lejoni të pyes fillimisht anëtarët e Komisionit më tej dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, nëse kanë ndonjë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar? Kolegë? Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore? Po, zoti Logu!

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.02.2022*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zonja Nano! Në fakt ne kemi një çështje të cilën mendoj se duhet të krijohet mundësia nga ana e Komisionit Rregullator për të bërë disa ndërhyrje në një akt nënligjor të nxjerrë më përpara që ka të bëjë me aktin nënligjor nr. 9, dt.24.12.2020 dhe me vendimin nr. 2, të Komisionit Rregullator, datë 22 janar 2022. Në pikën 1 të këtij vendimi thuhet, “për sa i përket raportimeve të veprimtarive publike, periudha që kanë detyrim institucionet shtetërore dhe bashkitë është nga 31 janar 2022 deri më 6 mars 2022”. Nuk ka një përcaktim, po të arsyetojmë në mënyrë analoge, me një arsyetim të zgjeruar për sa i përket faktit se cila është periudha e ndalimit, ose detyrimit që kanë institucionet publike për të mos nxjerrë akte të cilat parashikojnë dhënien e përfitimit në kategori të caktuara të popullsisë. Këto të parashikuara nga neni 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor. Mendoj që mund të jetë ose një shtesë tek vendimi nr. 2 dt.22.01.2022 të Komisionit Rregullator, vetëm për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022, ose mund të jetë një rregullim që bëhet ndoshta nga vetë vendimi nr. 9, dt.24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Periudha gjatë të cilës shtrihen këto ndalimet në rastet kur kemi zgjedhje të pjesshme, qofshin ato zgjedhje që mund të jenë dhe të parakohshme. Në rastin konkret kur bëhet fjalë për zgjedhje të pjesshme vendore, mendoj që duhet të ketë një rregullim. E shtroj këtë kërkesë, sepse nga ana e subjektit zgjedhor të cilin unë përfaqësoj në këtë komision, janë ngritur disa çështje dhe shqetësime, denoncime publike lidhur me përdorimin e aseteve publike, nxjerrjen e akteve, punësime, etj., etj. Prandaj është me interes që të përcaktohet në mënyrë të saktë, që në momentin që adresojmë kallëzimet tona pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të kemi një bazë solide, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Logu! Do të lutesha që propozimin tuaj për një ndryshim konkret në një vendim konkret të Komisionit Qendror, ta paraqesni me

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.02.2022*

shkrim dhe ne ta shqyrtojmë në një nga mbledhjet e afërta. Pa dashur të hyj në interpretimin e mëtejshëm, neni që ju ju referuat në fjalinë e parë përcakton një periudhë gjatë të cilës aktivizohen ndalime. “Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re”. Për mua, vetëm për mua, pastaj është çështje e Komisionit Rregullator, ka të bëjë me zgjedhjet për kuvendin. Fakti që e lidh me formimin e qeverisë së re. Në çdo rast, propozimi juaj është i mirëpritur. Pra, propozim për një ndryshim konkret, në një vendim konkret të Komisionit Rregullator. Sa më shpejt të administrohet pranë administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, aq më shpejt edhe ne do ta marrim në shqyrtim. Po zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Për të qenë më konkretë, propozimi juaj konsiston në parashikimin e saktë të afatit, apo në identifikimin e qartë të veprimtarive të ndaluara? Më konkretisht ku konsiston propozimi juaj? Sigurisht që do të materializohet në formë të shkruar, apo jo?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po do ta sjellim të shkruar se çfarë nënkuptojmë me këtë konkretisht, por sigurisht lidhet me të dyja çështjet. Edhe me pjesën e saktësimit të veprimtarive të ndaluara, por dhe afatit të nxjerrjes së atyre akteve, të cilat në vlerësimin tonë e ndikojnë procesin zgjedhor të datës 6 Mars 2022. Veprimtaritë e ndaluara është e vërtetë që janë të parashikuara në vendimin nr. 9, dt.24.12.2020, po më shumë ka të bëjë me përcaktimin e një afati të qartë dhe të saktë. Ne do të kemi propozimin tonë se kur duhet të jetë ky afat.

**Z. M. Çakaj:** Akti që miratuam nga ana e këtij Komisioni Rregullator në datën 22.01.2022, parashikon datën 31. Pra, nga data 31 janar...

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Për sa i përket veprimtarive, por nuk parashikon se nga cili moment mund të fillojë ndalimi për të nxjerrë akte...

**Z. M. Çakaj:** Nga data 31 janar...

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Me interpretim, se akti që unë kam nuk e thotë këtë gjë, të paktën në mënyrë të shprehur, apo të qartë.

**Znj. I. Nano:** Dakord, le të presim propozimin konkret të shkruar...

**Z. M. Çakaj:** Ideja është këtu, në qoftë se ju keni denoncim konkret, unë besoj qoftë vendimi nr. 9, qoftë akti i miratuar nga Komisioni Rregullator në datën 22 janar e lejon, e mundëson. Në mungesë të një akti përsëri mund t'i referoheni nenit 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor. Në qoftë se ju doni të denonconi veprimtari të ndaluara në respekt të atij parashikimi. Pra, në qoftë se keni veprimtari konkrete, ne kemi ndërfaqe. Pra, në ndërfaqen e KQZ-së, ju mund të denonconi veprimtarinë dhe fillon hetimi nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për veprimtarinë e raportuar, apo denoncuar nga ana juaj.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Çakaj faleminderit! Ne në fakt kemi bërë dy denoncime publike në seancë me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Një ka të bëjë me nxjerrjen e një vendimi nga Këshilli Bashkiak Durrës, për sa i përket dhënies së granteve të rindërtimit për 526 familje dhe një denoncim tjetër që ka të bëjë me punësimin e 29 personave në Bashkinë Rrogozhinë. Megjithatë do të donim që në qoftë se Komisioni Rregullator që është organi që ka prodhuar këtë akt, interpreton që për të gjithë afatet duhet të llogaritet data 31 janar, për ne është e kuptueshme. Ne mendojmë që ka nevojë për një saktësim, në qoftë se interpretimi është ky ne vijojmë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Z. M. Çakaj:** Besoj se bashkë me kolegët të qartë kemi qenë kur kemi miratuar datën 31 janar.

**Znj. I. Nano:** Gjithësesi, në qoftë se ka një propozim konkret për një shtesë, apo ndryshim në një akt tonin, le të vijë. Ndërkohë ato denoncime që keni bërë pranë një organi tjetër drejtues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me sa e ndoqa seancën e mëparshme, besoj se do t'u jepet zgjidhja nëpërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

**Z. M. Çakaj:** Dakord, por unë mendoj se akti që kemi miratuar e mundëson denoncimin, çfarëdolloj denoncimi nga data 31 janar e këtij deri në 6 mars. Çfarëdolloj veprimtarie të cilën ju e konsideroni si veprimtari e ndaluar, keni të drejtë ta denonconi në faqen e KQZ-së. Pra, nuk është data 31 janar, nuk parakupton vetëm detyrimin e institucioneve për të raportuar pranë KQZ-së për veprimtaritë, por nënkupton edhe datën për ato gjashtë bashki, apo vendimmarrjen e institucioneve qendrore që ka pikë-prerje, apo ka fushë veprimtarie në këto gjashtë bashki, të mos kryejnë veprimtari të ndaluara. Besoj jemi të qartë kolegë për këtë pikë.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Çakaj, propozimi ynë, ose ngritja e kësaj çështje kishte si qëllim edhe këtë qartësim që ju sapo bëtë. Në qoftë se ky është qëndrimi i të gjithë anëtarëve të Komisionit Rregullator, kjo është një çështje e zgjidhur.

**Znj. I. Nano:** Zoti Logu, unë i qëndroj asaj që thashë më herët. Nuk është çështje që ne të bëjmë interpretim në seancë të një vendimi tonë, kur nuk konkludojmë me një vendimmarrje. Në momentin që keni propozim gati, niseni dhe

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.02.2022*

depozitohen pranë administratës dhe ne do ta shqyrtojmë. Nëse është propozim për shtesë, ndryshim në vendimet tona. Sigurisht në seancat me Komisionerin është vendi për të bërë diskutime qoftë të denoncimeve tuaja, të vendimmarrjes së tij apo dhe më tej në KAS. Po, zonja Vukaj!

**Znj. H. Vukaj:** Një shtesë, zonja Nano në meritë të asaj që dëgjova e komunikimit apo kundërpërgjigjes me pozitivitet që kolegët bënë për rastin e interpretimit. Në qoftë se zoti Logu, mbetet sërish i paqartë dhe mendon se norma ka vakum, apo nuk është plotësisht e interpretueshme, apo le vend për t'u interpretuar, atëherë është i lirë dhe ka gjithë të drejtën të propozojë një amendim, ndryshim, plotësim të argumentuar me rastet që kanë konstatuar, apo kanë denoncuar. Njëkohësisht referuar bazën ligjore ku ai e sheh qartësinë e interpretimit të asaj norme, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Vukaj, besoj se kjo çështje që ishte jashtë rendit të ditës u ezaurua.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



14.02.2022  
Ora 18:12

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në Vendet e Numërimit të Votave në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- |            |           |                               |
|------------|-----------|-------------------------------|
| • Ilirjana | NANO      | Kryetar                       |
| • Arens    | ÇELA      | Anëtar                        |
| • Dritan   | ÇAKA      | Anëtar                        |
| • Helga    | VUKAJ     | Anëtar                        |
| • Muharrem | ÇAKAJ     | Anëtar                        |
| • Stafi    | KQZ       | Y. Merkaj, I. Osmanaj         |
| Parti      | Politike: | PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj) |

**OJQ:**

*Znj. I. Nano:* Kalojmë në çështjen që kemi në rendin e ditës, shqyrtimin e projektvendimit “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në Vendet e Numërimit të Votave në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”. Ky projektvendim ka ardhur me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, do t’i lutesha zotit Merkaj, Sekretarit të Përgjithshëm të prezantonte në mënyrë të përmbledhur projektaktin, Zoti Merkaj!


Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.14.02.2022*

**Z. Y. Merkaj:** Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 13438, datë 20.01.2022, ka caktuar datën 6 Mars për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje. Neni 22, pika 2 i Kodit Zgjedhor përcakton kompetencën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të instaluar dhe përdorur sistemet e video-monitorimit gjatë numërimit manual të votave, në vendet e numërimit të votave, për të monitoruar dhe provuar rregullshmërinë e procesit në mjediset e brendshme të tyre. Në referim të nenit 23, pika 1 të Kodit Zgjedhor, përcaktohet procedura se si këto sisteme apo pajisje të teknologjisë së informacionit në zgjedhje, vihen në përdorim, sipas rastit, nga personeli i kualifikuar i KQZ-së, i punësuar për këtë qëllim, ose kur Rregullatori vendos, përdorimi i tyre bëhet nga operatorë privatë të kontraktuar sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin e shërbimeve. Në mbështetje të nenit 94, pika 4, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendos përdorimin e kamerave regjistruese me rezolucion të lartë dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre në vendin e numërimit të votave, të cilat instalohen mbi tavolinën e numërimit në mënyrë të tillë që bëjnë të mundur regjistrimin e vlerësimit të çdo flete votimi. Regjistrimi filmik transmetohet në kohë reale në monitorë të vendosur përballë vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, ruhet në medie elektronike dhe dorëzohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve së bashku me materialet e tjera zgjedhore. Për të monitoruar procesin e numërimit të votave në çdo VNV, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, do të realizojë edhe një sistem paralel monitorimi, i cili do të kryhet në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke i parë prej aty në monitorë, në kohë reale, këto VNV. Ky proces është përdorur që prej zgjedhjeve për Kuvend të vitit 2009, duke përbërë kështu një praktikë të konsoliduar të institucionit në zbatim të parimit të sigurisë dhe transparencës së procesit zgjedhor. Për sa më sipër i propozohet Komisionit Rregullator, për shqyrtim dhe miratim, projektvendimi “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në Vendet e Numërimit të Votave, në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Merkaj! Çelim diskutimin në parim për projektvendimin! Kolegë dhe përfaqësues të subjekteve zgjedhore në parim kemi diçka për të diskutuar lidhur me projektvendimin? Sigurisht është një projektvendim që vjen në kuadër të një praktike tashmë të konsoliduar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve të cilat shfaqin fletët e votimit në Vendet e Numërimit të Votave. Nëse nuk kemi diçka në parim, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit?

**Kush është dakord kolegë?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S’ka

Me 5 vota pro, miratohet në parim projektvendimi!

Projektvendimi ka gjashtë pika, unë po i lexoj. Komisioni Rregullator vendosi:

Pika 1. Përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve), për regjistrimin dhe shfaqjen e fletëve të votimit, në Vendin e Numërimit të Votave, në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

Ka ndonjë pyetje, diskutim, propozim? Nëse jo kalojmë në votimin e pikës 1.

**Kush është dakord kolegë?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 2. Përdorimin e sistemit të transmetimit video në kohë reale të monitorimit të numërimit të votave nga Vendet e Numërimit të Votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Diskutime nuk ka! Kalojmë në diskutimin e pikës 2.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 3. Përdorimi i kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve), dhe sistemi i transmetimit video në kohë reale nga Vendet e Numërimit të Votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të bëhet në bazë të rregullave procedurale të miratuara me akt normativ nga Komisioni Rregullator.

Kemi diçka për pikën 3? Jo! Atëherë kalojmë në votimin e pikës 3!

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 4. Përdorimi i kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) dhe sistemi i transmetimit video në kohë reale nga Vendet e Numërimit të Votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, kryhet nga operatorë të kontraktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik. Komentë, pyetje, diskutime? Jo! Kalojmë në votimin e pikës 4.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

***Kush është dakord kolegë?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit. Edhe njëherë kolegë, pasi e kemi votuar në parim dhe nen për nen e votojmë në tërësi projektvendimin sipas përmbajtjes së draftit që na ka ardhur.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Para se të mbyllim mbledhjen, thjesht do të doja të sillja në vëmendje faktin që pas miratimit të këtij projektvendimi që tashmë është vendim, do të duhet shumë shpejt edhe rregullat proceduriale për përdorimin e kamerave regjistruese dhe monitorëve si dhe sistemin e transmetimit video në kohë reale nga VNV-të në ambjentet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. duke qenë se nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës apo jashtë rendit të ditës për të diskutuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

**Vendimi nr. 17**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

